



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.76/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Bekim Haxhiut kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë **03.02.2026**, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.76/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu - kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të aprovohet e bazuar ankesa, të anulohet vendimi i KQZ-së sa i përket pjesës së ndarjes së mandateve për deputet në bazë të kuotës gjinore, dhe të detyrohet KQZ-ja të rishqyrtoj dhe rivendos çështjen, bazuar në renditjen reale të kandidatëve sipas votave, duke respektuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përmes së cilës pala ankuese z. Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), fiton mandatin e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i renditur i njëzeti (20), në listën e PDK-së, që ka fituar 22 mandate, i votuar me 21,520 (njëzet e njëmijë e pesëqind e njëzet) vota në zgjedhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme të mbajtura me 28.12.2025.

A r s y e t i m

Më datë 02.02.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.76/2026 nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën thekson se me datën 31.01.2026 në ora 11:00, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare dhe ka bërë ndarjen e mandateve për deputet, ku ankuesi Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ka fituar gjithsej 21,520 (njëzet e një mijë e pesëqind e njëzet) vota personale dhe është renditur i njëzeti (20) në listën përfundimtare të kandidatëve të PDK-së sipas numrit të votave të fituara. Megjithatë, pavarësisht faktit se ankuesi ka fituar numër më të madh votash

personale se disa kandidatë të tjerë të shpallur të zgjedhur si deputetë nga ana e KQZ-së, ankuesi është përjashtuar nga ndarja e mandateve për shkak të zbatimit dhe përlllogaritjes së gabuar të kuotës gjinore prej tridhjetë për qind (30%). Parashtruesi i ankesës thekson se zbatimi i kuotës gjinore nga ana e KQZ-së është bërë në mënyrë automatike dhe mekanike, pa vlerësim proporcional dhe pa balancim me parimin kushtetues të barazisë së votës, dhe se një zbatim i tillë ka përmbysur renditjen reale të kandidatëve sipas votave të fituara dhe ka cenuar drejtpërdrejt vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të shprehur përmes votës së lirë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë. Si pasojë e këtij zbatimi formalist të kuotës gjinore, ankuesi ndonëse i renditur i njëzeti (20) sipas votave personale të fituara, në listën e PDK-së që ka fituar 22 mandate, ka mbetur jashtë listës përfundimtare të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu siç është shpallur nga KQZ-ja.

Parashtruesi i ankesës thekson se kjo ankesë parashtrohet në mbështetje të drejtpërdrejtë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore përkatësisht: Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 24 (Barazia para ligjit), që garanton barazinë para ligjit dhe ndalon çdo formë diskriminimi; Nenin 45 (Liritë dhe të drejtat zgjedhore), që garanton të drejtën e votës së lirë dhe të barabartë, si dhe në parimet kushtetuese të proporcionalitetit dhe të ndalimit të diskriminimit, Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, veçanërisht neni 4, paragrafi 1.1 që garanton votën e lirë të barabartë dhe efektive, neni 4, paragrafi 12, që garanton barazinë në ushtrimin e të drejtës për t'u zgjedhur pa diskriminim, përfshirë diskriminimin në bazë të gjinisë; neni 4, paragrafi 1,9, që obligon respektimin e kuotës gjinore, por brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore; neni 106, paragrafi 3, që i njeh të drejtën ankimit çdo personi të cilit i janë cenuar të drejtat ligjore nga vendimi i KQZ, neni 111, që përcakton ndarjen e vendeve në Kuvend mbi bazën e votave të fituara në sistemin e listave të hapura. Parashtruesi i ankesës tutje thekson se sipas nenit 4, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 08/ L-228, zgjedhjet mbahen në bazë të votës së lirë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, dhe se vendimi i kontestuar i KQZ-së e ka cenuar këtë parim, pasi votat e fituara nga ankuesi nuk kanë prodhuar efekt të barabartë juridik në raport me votat e dhëna për kandidatë të tjerë me më pak mbështetje elektorale. Në mënyrë konkrete, nga subjekti politik PDK kandidatët znj. Ariana Musliu Shoshi me 19,964 vota dhe znj. Arbnore Salihu me 17,323 vota, respektivisht me 1,556 dhe 4,197 vota më pak se ankuesi, janë shpallur deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës me vendimin e KQZ-së, ndërsa ankuesi është përjashtuar nga mandati. Ky trajtim i pabarabartë i votës përbën shkelje substanciale të së drejtës zgjedhore dhe cenim të parimit të barazisë së votës. Neni 28 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme e përcakton kuotën gjinore si masë afirmative për sigurimin e përfaqësimit minimal gjinor. Ky nen nuk autorizon përjashtimin automatik të kandidatëve me më shumë vota personale, as përmbysjen e renditjes reale të kandidatëve sipas vullnetit të votuesve. Në rastin konkret, KQZ e ka zbatuar këtë dispozitë në mënyrë mekanike, pa e balancuar me nenin 4 të të njëjtit ligj dhe me parimet kushtetuese, duke e shndërruar masën afirmative në masë diskriminuese ndaj ankuesit, dhe se sipas nenit 4 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 08/ L-228 dhe nenit 24 të Kushtetutës, ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për t'u zgjedhur zbatimin konkret i kuotës gjinore ka prodhuar efekt diskriminues direkt, duke penalizuar kandidatin për deputet tashmë palë ankuese, jo për mungesë votash, por, për shkak të përkatësisë së tij gjinore. Pra, ky efekt përbën diskriminim jo proporcional dhe të pajustificuar, në kundërshtim me qëllimin legjitim të masave afirmative. Për më tepër, neni 111

përcakton se vendet në Kuvend ndahen në përpjesëtim me numrin e votave të fituara në zgjedhjet e hapura, dhe se vendimi i KQZ ka devijuar nga ky parim, duke mos respektuar renditjen sipas votave individuale dhe duke cenuar thelbin e përfaqësimit proporcional. Në kuptim të nenit 106 paragrafi 3, pala ankuese thekson se i janë cenuar të drejtat ligjore dhe kushtetues nga vendimi i KQZ-së pasi që i njëjti vendim i kontestuar nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm juridik dhe kushtetues lidhur me mënyrën e balancimit të kuotës gjinore me parimin e barazisë së votës, duke krijuar pasiguri juridike dhe arbitraritet. Parashtruesi i ankesës thekson se Ligji për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës e përcakton barazinë gjinore si përfaqësim të barabartë, në parim pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, si standard drejt të cilit institucionet publike janë të obliguara të synojnë, ndërsa kuota prej tridhjetë për qind (30%) e paraparë në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme është afirmativ dhe synon garantimin e përfaqësimit fillestar gjinor në garë, e jo krijimin e pabarazive të reja, dhe se zbatimi i kësaj kuote afirmative në mënyrë që prodhon përjashtimin e kandidatëve me legjitimitet më të lartë elektoral nuk e realizon qëllimin e barazisë reale gjinore dhe nuk është në harmoni me frymën e Ligjit për Barazi Gjinore. Në rastin konkret, KQZ, nuk ka dëshmuar se përjashtimi i ankuesit ka qenë masë e domosdoshme për arritjen e barazisë gjinore. Me nenin 64 të Republikës së Kosovës, vota e qytetarëve është element përcaktues për fitimin e mandatit, dhe çdo interpretim i nenit 28 që e zhvendos kuotën gjinore afirmative nga faza e kandidimit në fazën e ndarjes së mandateve, duke përjashtuar kandidatë me më shumë vota, përbën cenim të parimit të kushtetutshmërisë. Parashtruesi i ankesës thekson se me mekanizmin e kuotave gjinore në shpërndarjen e mandateve, sipas rezultateve të KQZ-së, kandidatë me më pak vota fitojnë mandate, ndërsa ata me më shumë vota mbesin jashtë Kuvendit, sikurse është rasti i palës ankuese z.Bekim Haxhiu. Kjo situatë bie në kundërshtim me Nenin 64 të Kushtetutës, i cili përcakton se Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli me votim të fshehtë, pra, në rastet kur një kandidate femër me më pak vota merr një mandat që ndryshe do t'i takonte një kandidati mashkull me më shumë vota, kemi një shkelje të vullnetit të sovranit. Në vend që populli të vendosë për përbërjen e Kuvendit, një mekanizëm artificial ndërhyr në rezultatet zgjedhore, duke deformuar përfaqësimin real të zgjedhësve. Neni 45 i Kushtetutës së Kosovës garanton se çdo qytetar ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në mënyrë të barabartë. Mirëpo, në rastin kur një kandidat mashkull sikurse është rasti me palë ankuese, me mijëra vota mbetet jashtë Kuvendit, ndërsa një kandidate femër me më pak vota fiton një mandat, kemi një cenim të drejtpërdrejtë të barazisë së votës, sepse votat e qytetarëve nuk trajtohen në mënyrë të barabartë, pasi disa vota kanë më shumë ndikim, peshë apo vlerë se të tjerat. Diskriminimi i kundërt dhe Neni 24 paragrafi 2 i Kushtetutës ndalon çdo formë diskriminimi dhe garanton trajtim të barabartë para ligjit për të gjithë qytetarët, dhe në këtë kontekst, favorizimi i një kandidature mbi një tjetër vetëm për shkak të gjinisë, përbën një diskriminim të kundërt, dhe se vendimi i KQZ-së, i datës 31.01,2026, nuk e trajton çdo kandidat si të barabartë përpara ligjit, por i jep një avantazh artificial njëres gjini, duke krijuar një padrejtësi strukturore. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme parashikon kuotën afirmative 30% për gratë në listat zgjedhore dhe mekanizmin e rregullimit të mandateve pas zgjedhjeve për të garantuar këtë përfaqësim. Ligji për Barazinë Gjinore (Ligji Nr. 05/L-020) ka rritur përqindjen në 50%, cluke synuar përfaqësim të barabartë, por pa parashikuar qartë një mekanizëm për garë të barabartë 50/50, dhe për shpërndarjen e mandateve pas numërimit të votave. Në praktikë kjo ka çuar në situata ku kandidatët nuk përzgjidhen vetëm mbi bazën e votave që marrin, por mbi një mekanizëm që

mund të favorizojë një gjini ndaj tjetrës, dhe që rrjedhimisht përbënë diskriminim kundër kushtetues. Andaj, i njëjti kërkon nga PZAP-i, që në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kushtetuese, dhe, pas shqyrtimit të argumenteve, administrimit të aprovohet e bazuar ankesa, të anulohet vendimi i KQZ-së sa i përket pjesës së ndarjes së mandateve për deputet në bazë të kuotës gjinore, dhe të detyrohet KQZ-ja të rishqyrtoj dhe rivendos çështjen, bazuar në renditjen reale të kandidatëve sipas votave, duke respektuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përmes së cilës pala ankuese z. Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), fiton mandatin e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i renditur i njëzet (20), në listën e PDK-së, që ka fituar 22 mandate, i votuar me 21,520 (njëzet e njëmijë e pesëqind e njëzet) vota në zgjedhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme të mbajtura me 28.12.2025.

Në përgjigje në ankesë KQZ thekson se pretendimi i ankuesit se zbatimi i kuotës gjinore cenon barazinë e votës dhe të drejtën për t'u zgjedhur nuk qëndron në raport me arkitekturën kushtetuese të Kosovës. Neni 7 i Kushtetutës përcakton barazinë gjinore si vlerë themelore të rendit kushtetues. Kjo dispozitë nuk ka karakter deklarativ, por imponon detyrim pozitiv për institucionet publike që të ndërmarrin masa për realizimin e barazisë reale në përfaqësim. Neni 24 i Kushtetutës garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin, ndërsa neni 45 garanton të drejtën zgjedhore dhe të pjesëmarrjes në jetën publike. Këto dispozita nuk lexohen në izolim, por në harmoni me njëra-tjetrën dhe në dritën e nenit 53 të Kushtetutës, i cili kërkon interpretim të të drejtave themelore në përputhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut. Kushtetuta, përmes nenit 71, njeh shprehimisht dimensionin e barazisë gjinore në përfaqësim politik. Ky nen e vendos parimin se përfaqësimi në Kuvend duhet të reflektojë barazi gjinore, duke i dhënë legjislatorit hapësirë për të parashikuar mekanizma afirmativë. Kuota gjinore nuk është devijim nga parimi i barazisë, por instrument kushtetues për realizimin e tij.

Neni 28 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton kuotën minimale gjinore prej 30% dhe mekanizmin korrektues për ndarjen e mandateve. Kjo dispozitë nuk i jep KQZ-së diskrecion vlerësues, por vendos një detyrim të qartë normativ për zbatim. KQZ, si organ administrativ kushtetues sipas nenit 139 të Kushtetutës, është i detyruar të zbatojë ligjin ashtu siç është miratuar nga Kuvendi, KQZ nuk ka kompetencë të rishkruajë, relativizoj apo balancojë normën ligjore mbi bazë të konsideratave subjektive për proporcionalitet. Çdo moszbatim i mekanizmit të paraparë në nenin 28 do të përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të ligjit. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e masave afirmative gjinore. Në aktgjykimin për rastet KI45/20 dhe KI46/20, Gjykata theksoi se barazia reale nuk reduktohet në trajtim formal identik, por lejon masa korrigjuese për të eliminuar pabarazitë strukturore në përfaqësim politik. Gjykata sqaroi se masat afirmative gjinore nuk përbëjnë diskriminim të ndaluar, por instrument legjitim për realizimin e barazisë substanciale. Më tej, në aktgjykimin KO15/24, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar shprehimisht kushtetutshmërinë e nenit 28 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ka konstatuar se kuota gjinore nuk është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës, Gjykata e ka konsideruar këtë dispozitë si mekanizëm proporcional dhe të lejueshëm në funksion të realizimit të barazisë gjinore në përfaqësim. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë efekt detyrues sipas nenit 116 të Kushtetutës. KQZ është e detyruar të veprojë në përputhje me këtë

interpretim kushtetues. Në rastin konkret, subjekti politik përkatës ka fituar 22 mandate, sipas nenit 28 të ligjit, minimumi prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar përkthehet në 7 mandate - meqenëse përpjesëtimi jep numrin 6,6, që si i tillë rrumbullakohet në 7. KQZ ka verifikuar përbërjen gjinore të kandidatëve fitues sipas votave preferenciale dhe ka konstatuar se pa mekanizëm korrektues nuk arrihej pragu minimal, që në rast se do të ishte 6 mandate, do të ishte poshtë kuotës prej 30% (-27%). Zbatimi i kuotës është bërë në mënyrë strikte dhe sipas renditjes së votave brenda gjinisë së nën përfaqësuar, duke zëvendësuar kandidatin e fundit të gjinisë së mbi përfaqësuar brenda listës së fituesve. Ankuesi rezulton pikërisht kandidati në këtë pozitë. Nuk ka pasur zgjedhje diskrecionale, favorizim selektiv apo devijim nga formula ligjore. KQZ ka ndërhyrë vetëm në masën e domosdoshme për arritjen e minimumit ligjor. Nuk ka tejkalim të kuotës, nuk ka aplikim të zgjeruar, dhe nuk ka cenim të strukturës së përgjithshme të rezultatit zgjedhor. Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, rezulton qartë se kontestimi i ankuesit nuk ka të bëjë me ndonjë gabim të KQZ-së, në zbatim të ligjit, por me mosmarrëveshje me vetë modelin normativ të përfaqësimit gjinor të përcaktuar nga legjislatori dhe të konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese. Një kundërshtim i tillë nuk mund të zgjidhet përmes moszbatimit të ligjit nga organi administrativ, sepse KQZ nuk ka as kompetencë dhe as diskrecion për të devijuar nga norma e detyrueshme. Në rastin konkret, KQZ ka vepruar në mënyrë strikte në përputhje me nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke aplikuar mekanizmin korrektues vetëm në masën minimale të domosdoshme për arritjen e pragut ligjor prej 30% të përfaqësimit të gjinisë së nën përfaqësuar. Përlllogaritja është bërë mbi bazë të saktë, ndërhyrja është kufizuar vetëm te kandidati i fundit i gjinisë së mbi përfaqësuar brenda listës së fituesve dhe përzgjedhja e kandidatit zëvendësues është bërë sipas renditjes së votave brenda gjinisë së nën përfaqësuar. Nuk ekziston asnjë element që të tregojë zbatim selektiv, tejkalim të kuotës apo cenim të strukturës së përgjithshme të rezultatit zgjedhor. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e trajton barazinë gjinore si vlerë themelore dhe lejon masa afirmative për realizimin e barazisë reale, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar shprehimisht se kuota gjinore është mekanizëm i lejueshëm dhe proporcional në kuadër të të drejtave zgjedhore. Në këtë kontekst, veprimi i KQZ-së nuk përbën devijim nga parimi i barazisë, por zbatim të drejtpërdrejtë të tij. Për rrjedhojë, nga pikëpamja kushtetuese, ligjore dhe faktike, vendimi i KQZ-së për ndarjen e mandateve është rezultat i një zbatimi korrekt të normës detyruese dhe nuk përmban asnjë shkelje që do të justifikonte ndërhyrjen e organit shqyrtues.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës ka konstatuar se:

- *Ankesa është e pabazuar*

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara dhe se KQZ-ja ka vepruar drejt sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt, andaj vendimi i KQZ-së, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Dispozita e nenit 28 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton kuotën minimale gjinore prej 30% për të dy gjinitë, ndërsa neni 111 par.5 të

LZP-se, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 2 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Në Nenin 111 par.6 të LZP-se, në mënyrë decisive thuhet se : *“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në par.5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%”*.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga subjekti politik PDK janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, dhe njëherit kandidatët nga subjekti politik PDK janë zgjedhur duke u bazuar në nenin 28 dhe 111 par.6 të LZP-së për të arritur përfaqësimin e minimumit të 30 % të gjinisë së kundërt.

Subjekti politik PDK, në këto zgjedhje ka fituar 22 mandate, sipas nenit 28 të ligjit, minimumi prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar përkthehet në 7 mandate - meqenëse përpjesëtimi jep numrin 6,6, që si i tillë rrumbullakohet në 7.

Andaj KQZ ka vepruar drejt kur ka bërë verifikimin e përbërjes gjinore të kandidatëve fitues sipas votave preferenciale dhe ka konstatuar se pa mekanizëm korrektues nuk arrihej pragu minimal, që në rast se do të ishte 6 mandate, do të ishte poshtë kuotës prej 30% (-27%). Andaj zbatimi i kuotës është bërë në mënyrë strikte dhe sipas renditjes së votave brenda gjinisë së nën përfaqësuar, duke zëvendësuar kandidatin e fundit të gjinisë së mbi përfaqësuar brenda listës së fituesve, në të cilin ankuesi ka rezultuar pikërisht kandidati në këtë pozitë. Paneli mori parasysh faktin se me përfaqësimin prej 7 kandidatëve të gjinisë femërore në rastin konkret, përfaqësimi tejkalon kuotën mbi 30%, mirëpo kjo nuk bie ndesh me frymën e ligjit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, andaj dhe nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për tension ndërmjet parimit të barazisë gjinore dhe parimit të barazisë së votës, e as diskriminim apo favorizim të një kandidature për shkak të gjinisë, prandaj vendosi që ankesën e kandidatit ta refuzojë si të pabazuar.

Është vlerësim i Panelit se përfaqësimi gjinor nuk është vetëm një kërkesë formale në përbërjen e listës, por një detyrim që zbatohet edhe gjatë shpërndarjes së mandateve, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim efektiv i të dy gjinive në institucionet e zgjedhura. Nëse shpërndarja e mandateve bazuar në votat e arritura do të çonte në përfaqësim nën 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, ulësja i takon kandidatit/kandidates së asaj gjinie, edhe nëse kandidati tjetër ka më shumë vota, për shkak se mbizotëron parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor, i paraparë me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, pretendimi i kandidatit në ankesë se ulësja në Kuvendin e Kosovës i takon atij nuk qëndron ligjërisht, pasi një veprim i tillë do të

shkelte dispozitat mbi kuotën gjinore dhe do të cenonte përfaqësimin minimal prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në Kuvend të Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin KO15/24, ka vlerësuar shprehimisht kushtetutshmërinë e nenit 28 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ka konstatuar se kuota gjinore nuk është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës, Gjykata e ka konsideruar këtë dispozitë si mekanizëm proporcional dhe të lejueshëm në funksion të realizimit të barazisë gjinore në përfaqësim.

Njëherit për raste të njëjta, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila për raste të njëjta ka vendosur me Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20, në të cilin aktgjykim ndër të tjera thuhet se, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mos diskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimi të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues. Tutje, Gjykata potencoi se, ratio legis i LZP, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron-në çdo rrethanë-përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nën përfaqësuar ose gjinisë pakicë. Mirëpo qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin 40 minimal të përfaqësimit të njëres gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të behën në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë që e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtuar, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së, e po ashtu kjo vendosje nuk cenon përcaktimin e vullnetit të votuesit, e as nuk bie në kundërshtim me praktikën e zgjedhjeve e as me praktikën e GJEDNJ-së, sikurse e pretendon pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.76/2026, datë 03.02.2026

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.10/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Milena Djerić, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.76/2026, të datës 03.02.2026, në seancën e mbajtur më datë 09.02.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.76/2026, i datës 03.02.2026, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.76/2026, të datës 03.02.2026, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa, ZP.Anr.76/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu - kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të aprovohet e bazuar ankesa, të anulohet vendimi i KQZ-së, sa i përket pjesës së ndarjes së mandateve për deputet në bazë të kuotës gjinore, dhe të detyrohet KQZ-ja, të rishqyrtoj dhe rivendos çështjen, bazuar në renditjen reale të kandidatëve sipas votave, duke respektuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përmes së cilës pala ankuese z. Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), fiton mandatin e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i renditur i njëzeti (20), në listën e PDK-së, që ka fituar 22 mandate, i votuar me 21,520 (njëzet e njëmijë e pesëqind e njëzet) vota në zgjedhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme të mbajtura me 28.12. 2025.

Kundër vendimit të PZAP, kandidati për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, me propozim që të aprovohet e bazuar, ankesa e paraqitur kundër Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, të datës 03.02.2026, ZP.Anr.76/2026, të anulohet, vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP.



dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve - KQZ, sa i përket pjesës së ndarjes së mandateve për deputet në bazë të kuotës gjinore, ashtu që pala ankuese, Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), të fiton mandatin e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i renditur i njëzeti (20), në listën e PDK-së, që ka fituar 22 mandate, dhe të urdhërohet, KQZ-ja, që të bëjë korrigjimin apo rishpallje të rezultateve përfundimtare.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidati për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.76/2026, të datës 03.02.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të atakuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 02.02.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr. 76/2026 nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke kërkuar saktësisht si në ankesën e paraqitur, në PZAP.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr. 76/2026, të datës 03.02.2026, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara dhe se KQZ-ja, ka vepruar drejt sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt, andaj vendimi i KQZ-së, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Ka shtuar se dispozita e nenit 28 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton kuotën minimale gjinore prej 30% për të dy gjinitë, ndërsa neni 111 paragrafi 5 të LZP-së, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 2 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Në nenin 111 paragrafi 6 të LZP-së, në mënyrë decitive thuhet se: “Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%”.



Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga subjekti politik PDK janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, dhe njëherit kandidatët nga subjekti politik PDK, janë zgjedhur duke u bazuar në nenin 28 dhe 111 paragrafi 6 të LZP-së, për të arritur përfaqësimin e minimumit të 30% të gjinisë së kundërt.

Ka shtuar se subjekti politik PDK, në këto zgjedhje ka fituar 22 mandate, sipas nenit 28 të ligjit, minimumi prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar përkthehet në 7 mandate meqenëse përpjesëtimi jep numrin 6,6, që si i tillë rrumbullakohet në 7. Andaj KQZ, ka vepruar drejt kur ka bërë verifikimin e përbërjes gjinore të kandidatëve fitues sipas votave preferenciale dhe ka konstatuar se pa mekanizëm korrektues nuk arrihej pragu minimal, që në rast se do të ishte 6 mandate, do të ishte poshtë kuotës prej 30% (-27%). Andaj zbatimi i kuotës është bërë në mënyrë strikte dhe sipas renditjes së votave brenda gjinisë së nën përfaqësuar, duke zëvendësuar kandidatin e fundit të gjinisë së mbi përfaqësuar brenda listës së fituesve, në të cilin ankuesi ka rezultuar pikërisht kandidati në këtë pozitë. Paneli mori parasysh faktin se me përfaqësimin prej 7 kandidatëve të gjinisë femërore në rastin konkret, përfaqësimi tejkalon kuotën mbi 30%, mirëpo kjo nuk bie ndesh me frymën e ligjit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, andaj dhe nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për tension ndërmjet parimit të barazisë gjinore dhe parimit të barazisë së votës, e as diskriminim apo favorizim të një kandidature për shkak të gjinisë, prandaj vendosi që ankesën e kandidatit ta refuzojë si të pabazuar.

Ka theksuar se është vlerësim i Panelit, se përfaqësimi gjinor nuk është vetëm një kërkesë formale në përbërjen e listës, por një detyrim që zbatohet edhe gjatë shpërndarjes së mandateve, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim efektiv i të dy gjinive në institucionet e zgjedhura. Nëse shpërndarja e mandateve bazuar në votat e arritura do të çonte në përfaqësim nën 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, ulësja i takon kandidatit/kandidates së asaj gjinie, edhe nëse kandidati tjetër ka më shumë vota, për shkak se mbizotëron parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor, i paraparë me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, pretendimi i kandidatit në ankesë se ulësja në Kuvendin e Kosovës i takon atij nuk qëndron ligjërisht, pasi një veprim i tillë do të shkelte dispozitat mbi kuotën gjinore dhe do të cenonte përfaqësimin minimal prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në Kuvend të Republikës së Kosovës.

Andaj Paneli, ka vlerësuar se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i ka refuzuar, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së, e po ashtu kjo vendosje nuk cenon përcaktimin e vullnetit të votuesit, e as nuk bie në kundërshtim me praktikën e zgjedhjeve e as me praktikën e GJEDNJ-së, sikurse e pretendon pala ankuese.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bekim Haxhiut, lidhur me pretendimet për llogaritjen e kuotës gjinore dhe zëvendësimit të tij me kandidatet e gjinisë femërore të të njëjtes parti.



Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së, edhe për zbatim të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 28 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “1. Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) janë femra, me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë. 2. Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë”.

Me nenin 111 paragrafi 1, 5 dhe 6 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës. 5. Vendet që i ndahen subjektit politik në paragrafin 2 të këtij neni u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik në paragrafin 4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listë sipas një renditje zbritëse, deri në mbarim të vendeve që i ndahen subjektit politik pavarësisht numrit të votave të kandidatëve. Vendet shtesë që u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sikurse në paragrafin 3 të këtij neni u ndahen kandidatëve pasues nga lista e rirenditur nga paragrafi 4 i këtij neni e kandidatëve të subjektit politik. 6. Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku tridhjetë për qind (30%) nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku tridhjetë për qind (30%). Ky paragraf nuk zbatohet ndaj ndarjes së vendeve nga lista që përbëhet prej një (1) apo dy (2) kandidatëve”.

Me nenin 24 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në testin e mëtejshëm – KRK) përcaktohet se: “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”.

Me nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KRK, përcaktohet se: 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë ikufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozita e lartcekur, erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm. Në rastin konkret bazuar në dispozitën ligjore nga neni 28 paragrafi 1 dhe 2 dhe



neni 111 paragrafi 1, 5 dhe 6 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, rezulton fakti se lista finale e kandidatëve për deputet duhet të përfshijë së paku tridhjetë përqind (30%) të kandidatëve me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.

Bazuar në dispozitat ligjore për barazinë gjinore në përfaqësim, ndarja e mandateve duhet të respektojë parimin e përfshirjes minimale prej 30% për secilën gjini, si në fazën e përpilimit të listave të kandidatëve, ashtu edhe në fazën përfundimtare të ndarjes së mandateve. Së pari, sipas nenit 28 paragrafi 1 të LPZ-së, të cituar më lartë, lista e kandidatëve të çdo subjekti politik duhet të përmbajë së paku 30% femra dhe 30% meshkuj, si dhe të sigurojë përfaqësim gjinor të shpërndarë në mënyrë të rregullt, me nga një kandidat të secilës gjini në çdo grup prej tre kandidatësh. Ky rregull synon jo vetëm barazinë formale në listë, por edhe krijimin e kushteve reale që kjo barazi të reflektohet në përfaqësimin përfundimtar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret, subjekti politik PDK, ka fituar 22 mandate, ndërsa llogaritja e kuotës minimale gjinore prej 30% mbi këtë numër mandatesh rezulton të jetë 7 mandate që duhet t'i përkasin gjinisë pakicë e që në rastin konkret është përmbushur me të drejtë nga ana e KQZ-së.

Bazuar në nenin neni 111 paragrafi 6 të LQP-së, rezulton fakti se, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë (meshkuj) duhet të zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë (femra) në listën e rirenditur, dhe ky proces përsëritet derisa të arrihet minimumi prej 30% përfaqësim për gjininë pakicë, prandaj duke pas parasysh se ankuesi - kandidati për deputet Bekim Haxhiu është i radhitur si kandidat i fundit i shumicës i zgjedhur sipas votave, rezulton se i njëjti duhet të zëvendësohet me kandidatin e gjinisë pakicë, siç ka vepruar KQZ, me të drejtë në rastin konkret. Ky mekanizëm është detyrues dhe nuk lë hapësirë diskrecioni, për aq kohë sa lista përbëhet nga më shumë se dy kandidatë, çka në rastin konkret plotësohet. Për rrjedhojë, nëse pas ndarjes fillestare të 22 mandateve gratë përfaqësohen me më pak se 7 mandate, ndarja konsiderohet në kundërshtim me ligjin, dhe duhet të korrigjohet domosdoshmërisht në favor të gjinisë femërore, deri në arritjen e kuotës minimale ligjore.

Në raport me pretendimet e ankuesit, se vendimi KQZ dhe ai i PZAP-së, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 4 të LQP-së, dhe neneve 24, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se këto pretendime në tërësi janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se respektimi i kuotës gjinore prej 30%, ashtu siç përcaktohet në nenin 28 dhe nenin 111 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk bie në kundërshtim me nenin 4 të LQP-së, dhe as me nenet 24, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi këto dispozita duhet të interpretohen në mënyrë të integruar dhe sistematike. Neni 4 i LQP-së, përveçse garanton votën e lirë, të barabartë dhe ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, në pikën 1.9 vendos shprehimisht detyrimin për respektimin e kuotës gjinore, duke e bërë atë pjesë përbërëse të parimeve themelore të procesit zgjedhor.

Neni 24 i Kushtetutës jo vetëm që garanton barazinë para ligjit, por në paragrafin 3 të tij lejon masa të veçanta për mbrojtjen dhe përparimin e grupeve që ndodhen në pozitë të pabarabartë, çka e bën kuotën gjinore një masë afirmative të ligjshme dhe kushtetuese, e cila nuk përbën diskriminim, por synon realizimin e barazisë reale.



Neni 45 i Kushtetutës garanton të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, por kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me ligjin, dhe kuota gjinore nuk ua mohon këtë të drejtë kandidatëve apo votuesve, por vetëm rregullon mënyrën e përfaqësimit përfundimtar pa cenuar barazinë, lirinë apo fshehtësinë e votës.

Po ashtu, neni 64 i Kushtetutës parashikon sistemin e përfaqësimit proporcional dhe një mekanizma korrektues të përfaqësimit, siç janë vendet e garantuara për komunitetet jo-shumicë, duke dëshmuar se Kushtetuta pranon masa të veçanta për sigurimin e përfaqësimit gjithëpërfshirës. Në këtë kontekst, kuota gjinore prej 30% është plotësisht në harmoni me rendin kushtetues dhe ligjor dhe përbën zbatim të drejtpërdrejtë të parimeve të barazisë reale dhe demokracisë përfaqësuese, prandaj pretendimet për kundërshtim normativ janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se përfaqësimi gjinor nuk është vetëm një kërkesë formale në përbërjen e listës, por një detyrim që zbatohet edhe gjatë shpërndarjes së mandateve, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim efektiv i të dy gjinive në institucionet e zgjedhura. Nëse shpërndarja e mandateve bazuar në votat e arritura do të çonte në përfaqësim nën 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, ulësja i takon kandidatit/kandidates së asaj gjinie, edhe nëse kandidati/tjetër ka më shumë vota, për shkak se mbizotëron parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor, i paraparë me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në raport me pretendimet e palës ankuese se në rastin konkret kemi diskriminim, dhe trajtim të pabarabartë para ligjit, Gjykata Supreme e Kosovës këtë pretendim e refuzon në tërësi si të pabazuar. Kjo gjykatë vlerëson se respektimi i kuotës gjinore prej 30% nuk përbën diskriminim në raport me kandidatin e fundit të listës, pasi kjo masë buron drejtpërdrejt nga dispozitat ligjore detyruese dhe ka për qëllim realizimin e barazisë faktike ndërmjet gjinive. Kuota gjinore është masë afirmative e paraparë me ligj, e cila synon korrigjimin e pabarazive strukturore dhe historike në përfaqësimin gjinor, dhe si e tillë është në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Për më tepër duhet të theksohet fakti se zëvendësimi i kandidatit të fundit nuk bëhet mbi baza arbitrare apo subjektive, por si pasojë e drejtpërdrejtë e zbatimit të normës ligjore. Kandidati në fjalë nuk ka të drejtë të fituar absolute për të ruajtur pozitën, pasi pjesëmarrja në listë dhe renditja e tij kushtëzohen nga respektimi i kriterëve ligjore, përfshirë edhe kuotën gjinore. Për rrjedhojë, çdo kufizim që rezulton nga zbatimi i kuotës nuk cenon parimin e barazisë, por përbën një dallim të arsyetuar dhe proporcional, të lejuar nga ligji. Nga kjo rezulton se, kuota gjinore zbatohet në mënyrë të përgjithshme dhe neutrale ndaj të gjithë kandidatëve dhe nuk synon diskriminimin e një individi të caktuar, por garantimin e përfaqësimit minimal të gjinisë më pak të përfaqësuar. Në këtë kuptim, zëvendësimi i kandidatit të fundit është pasojë teknike e renditjes së listës dhe jo masë ndëshkuese apo diskriminuese ndaj tij. Si përfundim, respektimi i kuotës gjinore prej 30% përbën zbatim të ligjit dhe të parimit të barazisë substanciale, dhe nuk mund të konsiderohet diskriminim ndaj kandidatit të fundit që zëvendësohet në përputhje me kërkesat ligjore.

Prandaj, pretendimi i kandidatit në ankesë se mandati i deputetit i takon atij nuk qëndron ligjërisht, pasi një veprim i tillë do të shkelte dispozitat mbi kuotën gjinore dhe do të cenuar



përfaqësimin minimal prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AA.nr.10/2026, datë 09.02.2026.

Kryetari i kolegjit,
Rrustem Thaqi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlasćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA



KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES/ SUBSIDI SAVET KOSOVAL/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KESHILLIT GJYQESOR TE KOSOVES

GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Sheji i shkrësës
Oznaka spisa:

AA-10/2026

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

PZAP - PERSISTIVE POSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kështë dështë të bëhet dorëzimi I sa pas kësaj së lajmërit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendje në kohën e caktuar në bancesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë anëtarit madhor të familjes së marrësi - kujdestarit të ndërtësës, fjalit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji mi prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni pošto ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena odraslom članu domaćin. Primoca naslojniku zgrace suseda lica zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkrësës, shkresa u la në bancesë në vendin e punës së marrësi (duke e ngjitur në dorën e bancesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primoca (pribrano na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dani _____ u _____ ora _____
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Emri i shkrësës:
Naslov pisma koja se dostavlja:
AKTIVITETI
09.02.2026
Numri i shtojcave: _____
broj priloga **2**

Vërejtjet se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjuemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Atentat. 09.02.2026
(Nënshkrimi i marrësi ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primoca ili lica koje je
pismeno primilo u zamecu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Form 1200

(Të panevojshmeve bëri vizë - nepotrebne precratati)